# KONTRATE SHITJE KUOTASH

**PALA SHITESE: : Alket Kristaq Kumaraku**, i lindur me 09.07.1976 ne Berat dhe banues ne Tirane, Rruga "Xhanfize Keko" Pall.10, Ap.46,Tirane, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**PALA BLERESE: Arton Anesti Poro,** lindur me 19.05.1978 ne Fier, dhe banuese ne Tirane, Rruga "Mihal Duri" Pall.SON, Ap.23, Tirane, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**BAZA LIGJORE: 1.** Ligji 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"
**2.** Kodi Civil i Republikes se Shqiperise.

Sot, me 18.04.2023 ne seline e shoqerise "AR-MI PROJEKTIM MBIKEQYRJE" shpk u mblodhen palet per sa me poshte vijon:

## IDENTIFIKIMI I PALEVE

Identiteti i personave fizike, pale ne kontrate si dhe zotesia e tyre per te vepruar, u identifikua mbeshtetur ne dokumentet e identifikimit te paraqitura nga vete personat fizike, si dhe ne prezencen fizike te secilit.
Secili nga palet e ka zotesine juridike per te vepruar.
Nepermjet Ekstraktit te Gjendjes se Regjistrimit, leshuar nga QKB, u verifikua gjendja e regjistrimit te shoqerise "AR-MI PROJEKTIM MBIKEQYRJE" shpk dhe u konstatua se shoqeria eshte aktive.

Pronaret kane deklaruar personalisht se shoqeria "AR-MI PROJEKTIM MBIKEQYRJE" shpk eshte shoqeri aktive, nuk eshte ne proces falimentimi, nuk eshte ne ndjekje penale, nuk eshte nen sekuestro apo nen forma te tjera te kufizimit te zotesise se saj juridike dhe e lire per qarkullim civil te pjeseve te kapitalit te saj.

Personat si me siper identifikuar, me vullnet te lire dhe te plote, me kerkese te shprehur personalisht, te informuar e ne dijeni te pasojave ligjore ne rast deklarimi te pavertete, hartuan kete akt.

## RRETHANA PARAPRAKE

1. Shoqeria "AR-MI PROJEKTIM MBIKEQYRJE" shpk eshte regjistruar si person juridik shqiptar me pergjegjesi te kufizuar, identifikuar me numer NUIS: L81814008S, ka status aktiv, nuk evidentohen barresime e marreveshje kufizuese mbi pjeset e kapitalit te shoqerise.
2. Personi pale shites, si me siper, eshte ortak i shoqerise "AR-MI PROJEKTIM MBIKEQYRJE" shpk, duke zoteruar pesedhjete pjese te barabarte me 50 % te kapitalit. Vlera e kapitalit eshte 50 000 (pesedhjete mije) leke.

## OBJEKTI I KONTRATES

Objekti i kesaj kontrate eshte:

- Shitja prej **Pales Shitese, Alket Kumaraku** i 45 % te kuotave qe zoteron ne shoqeri.
- Blerja prej **Pales Blerese, Arton Poro** i totalit te kuotave, perndryshe 45 % te pjeseve te kapitalit nga Pala Shitese.
- Ortakeria pas kesaj shitje behet si vijon: Arton Poro behet ortak i shoqerise me 95% te kapitalit te barabarte me 95 (nentedhjete e pese) pjese dhe Alket Kumaraku me 5 (pese) pjese te kapitalit.

## CMIMI I KONTRATES

Me marreveshje te perbashket, te dy palet kane percaktuar se:

- Cmimi total per shitblerjen e 45% te kapitalit eshte 45 000 (dyzete e pese mije) leke.
- Palet deklarojne se cmimi total per shitblerjen eshte likuiduar totalisht nga bleresi perpara nenshkrimit te aktit.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, pronesia mbi kapitalin e shoqerise do te behet si vijon:

| | |
|---|---|
| **1. Arton Poro** | Numri i pjeseve 95 (nentedhjete e pese)<br>Pjesemarrja ne perqindje 95%. |
| **2.Alket Kumaraku** | Numri i pjeseve 5 (pese)<br>Pjesemarrja ne perqindje 5%. |

## DEPOZITIME TE PALEVE

Palet depozitojne dhe kerkojne qe kontrates ti bashkangjiten dhe te jene pjese integrale te saj edhe:

- Ekstrakti i regjistrit tregtar te shoqerise "AR-MI PROJEKTIM MBIKEQYRJE"shpk.
- Dokumentacioni i identifikimit te paleve.

Ky akt perpilohet ne kater kopje, te cilat ruhen nga palet dhe depozitohen prane QKB per t'u pasqyruar ndryshimi i pronesise se shoqerise "AR-MI PROJEKTIM MBIKEQYRJE" shpk sipas detyrimeve ligjore.

Sa me siper, me kerkese te shprehur te paleve, perpilohet kjo kontrate shitje kuotash, e cila iu lexua paleve me ze.

Palet deklarojne se e gjejne teresisht, e paragraf per paragraf, ne perputhje me vullnetin e tyre te lire e te plote, japin pelqimin e tyre per gjithshka me siper dhe e nenshkruan aktin rregullisht duke vendosur emer, mbiemer dhe firme.

| | |
|---|---|
| **PALA SHITESE**<br>*Alket Kumaraku* | **PALA BLERESE**<br>*Arton Poro* |
| Alket Kumaraku<br>23.04.18 | Arton Poro |